



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.138/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Adnan Kunushevci dhe Afijete Zogaj-Gllogjani anëtarë/e, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së tendës në hapsirë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** ankesa Anr.138/2019 e datës 30.09.2019, e paraqitur nga Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 2,600.00 euro (dy mijë e gjashtëqind), të cilën gjobë DETYROHET ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

Me datën 30.09.2019, Lëvizja Vetëvendosje ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 29 Shtator 2019 në orën 15:30, në rr.“Ismajl Qemali”, në qytetin e Gjakovës, kanë vërejtur se Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka vendosur “TENDË” dhe një “shtand”, në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së dhe rregullën zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Me propozim për panelin që të pranohet ankesa si e bazuar.

Në përgjigje në ankesë të datës 01.10.2019, subjekti politik PDK, konsideron se shkelja nuk është në kundërshtim me LZP, pasi që vendosja është bërë me marrëveshje me Komunën e Gjakovës, për vendosjen e Tendës në rr.“Ismajl Qemali” dhe shfrytëzimin e hapësirës publike, e cila dëshkohet me Pëlqimin e Përkohshëm nga Komuna e Gjakovës. Përgjigjes në ankesë ia ka bashkangjitur pëlqimin e lëshuar nga Komuna e Gjakovës për shfrytëzimin e sipërfaqes publike në rr.“Ismajl Qemali”.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se :

### **Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se tenda dhe shtandi me materialet zgjedhore të subjektit politik PDK, janë të vendosura në hapësirat publike në rr.“Ismajl Qemali” në qytetin e Gjakovës.

Nga dëshmitë e sipërcituara paneli në mënyrë të sigurt ka vërtetuar se nga subjekti politik PDK, me seli në Prishtinë, janë bërë shkeljet e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, nga fakti se, tenda dhe shtandi janë të vendosura në hapësirat publike, paraqesin veprime të sanksionuara me dispozitën e nenit 33 pika b) e LZP-

së, e cila përcakton “ *Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe postereve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve* ”..

Paneli, vendimin e tij e ka mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Parashtrimet në përgjigje në ankesë, se veprimet e subjektit politik PDK, nuk mund të sanksionohen si shkelje të LZP-së, për arsye se vendosja e tendës dhe shtandit në shesh duke shfrytëzuar hapësirat publike, është bërë me pëlqimin e Komunës së Gjakovës, nga data 30.09.2019 deri me 06.10.2019, Paneli pretendimet e tilla i vlerësoj si të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj pasi që, me këto prova nuk justifikon veprimet që janë të ndaluara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të Nenit 33 pika b) i LZP-së, si dhe neni 5 paragrafi 1 pika d) e Rregullës 13/2013, ku parashihet se subjektet e certifikuara politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t'i bëjnë në pajtueshmëri me Rregullat Zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ). Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit .

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se PDK-ja, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore.

Ndërmarrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjobës sepse nga fotografitë e dërguara si dëshmi në përgjigje në ankesë shifet se subjekti politik PDK, ka bërë përmirësimin e shkeljes, Paneli po ashtu vlerësoi se dënimi i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikoj që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.138/2019 më datën 02.10.2019

**Kryesues e Panelit**  
**Faton Ademi**



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.